



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr.55
Prishtinë, 11.7.2024, në orën 9:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni Kaloshi dhe Bahrim Shabani, nënkryetarë, Drita Millaku, Arijeta Rexhepi, Enis Kervan, Fridon Lala dhe Bekim Arifi, anëtarë.

Munguan: Elmi Reçica, Valentina Bunjaku Rexhepi, Shemsedin Dreshaj, Adem Hoxha dhe Fadil Gashi, anëtarë.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasa Prica Tisma, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni-Kaloshi nënkryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-288 për mbrojtjen e konsumatorit me raportin dhe amendamentet e Komisionit funksional për ekonomi, industri, ndërmarrësi dhe tregti;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-295 për krypto-asetet me raportin dhe amendamentet e Komisionit funksional për ekonomi, industri, ndërmarrësi dhe tregti;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

1. Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Nënkryetari paraqiti për shqyrtim pikat në vijim:

- 2. Projektligji nr. 08/L-288 për mbrojtjen e konsumatorit me raportin dhe amendamentet e Komisionit funksional për ekonomi, industri, ndërmarrësi dhe tregti;**

Nënkryetari kërkoi nga anëtarët e Komisionit që të paraqesin propozimet apo sugjerimet në lidhje me Projektligjin me raportin dhe amendamentet e Komisionit funksional.

Pasi që nuk ka pasur propozime dhe sugjerime të reja nga anëtarët e Komisionit, në bazë të votimit unanimit, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

1. Miratohet Projektligji me raportin dhe amendamentet e Komisionit funksional, sepse i njëjti nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.
2. Miratohet Projektligji nr. 08/L-295 për krypto - asetet me raportin dhe amendamentet e Komisionit funksional, sepse i njëjti nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 09:45.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Hydajet Hyseni Kaloshi,

Nënkryetar i Komisionit